K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 21670 *prot.* *Lezhë, më:* 05.11 *.2026*

PROJEKT-V E N D I M

NR. __—__, Datë 05-11- **, 2026**

PËR
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË DHE SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR, NË OBJEKTIN BALLDRE, NGA SHOQËRIA "LEZHA KONSTRUKSION" SH.P.K.

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor kombëtar sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë në pronësi të Bashkisë dhe në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur.
2. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor/kullosor kombëtar detajohet si mëposhtë:

- **2.92** ha kullotë në ngastrën pyjore **31**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".
- **1.37** ha kullotë në ngastrën pyjore **31b** ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit", pronë private, me numër pasurie **682/2 ZK 1783**.
- **0.35** ha kullotë në ngastrën pyjore **15e**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".

3. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore/kullosore të dëmtuar jashtë pjesës ku kryhet aktiviteti, bëhet nga shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k**, sipas marrëveshjes së dakortësuar me Bashkinë, pasi të miratohet heqja nga fondi pyjor.
4. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 21670/1 *prot.* *Lezhë, më:* 05-11-.2026

RELACION
PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË HEQJES NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR PËR SIPËRFAQET PYJORE/KULLOSORE BASHKIAKE DHE PRIVATE QË DO TË PREKEN NGA KRYERJA E AKTIVITETIT MINERAR TË SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR, NË OBJEKTIN BALLDRE, NGA SHOQËRIA "LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.

Shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.** ka paraqitur kërkesën online me datë 28.07.2026 pranë Ministrisë së Mjedisit, bazuar në Lejen e Shfrytëzimit minerar numër 647/3, datë 22.04.2024 dhënë për shoqërinë "Alba Kurbin" sh.p.k dhe transferuar me Aktin e Miratimit numër 647/4 nga MIE, si dhe Leje Mjedisi të tipit B me numër identifikimi 5049, datë 04.06.2026, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zhvillimin e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të gurit gëlqeror në objektin **BALLDRE**, Ekonomia Pyjore Mali i Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë që do të shërbejë për kryerjen e aktivitetit minerar.

Ministria Mjedisit, nëpërmjet shkresës së datës 19.08.2026 e admnistruar pranë Bashkisë Lezhë me numër 17686 protokoll datë 14.09.2025 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga leja e aktivitetit minerar, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor publik apo zgjerimin e tyre".

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga zhvillimi i aktivitetit minerar.

Sipërfaqet pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit,

dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", të ndryshuar dhe bëjnë pjesë në ngastrat pyjore **31, 31b** dhe **15e** të Ekonomisë Pyjore "**Mali i Kakarriqit**". Pasuria numër **682/2, ZK 1783** është **Pronë Private** në emër të personit juridik **LEZHA KONSTRUKSION**, në Ekonominë Pyjore "**Mali i Kakarriqit**" dhe i hiqet parcelës numër **31b**.

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë nga e cila **3.27 ha** është në pronësi të Bashkisë dhe **1.37 ha** në pronësi private, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

Hartoi relacionin
Inxh. Artan PALUSHI

DREJTORI
Paulin GJERGJI

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 2670/2 Prot. Lezhë më, 05 / 11 /2026

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Pjerin NDREU

RAPORT
MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË SI DHE NË PRONËSI PRIVATE.

Lloji i aktivitetit: *Leje minerare shfrytëzimi për mineralin gur gëlqeror, nga Shoqëria "LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.*

Bazuar në kërkesën online me datë 28.07.2026 të paraqitur nga Drejtoria e Biodiversitetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Mjedisit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për pregatitje të raportit tekniko ekonomik për heqje nga fondi pyjor publik të sipërfaqeve pyjore Bashkiake dhe private që preken nga Leja numër 647/3, datë 22.04.2024 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, grupi i punës i përbërë nga **Inxh. Ardit Molla, Inxh. Eralba Mirashaj dhe Inxh. Blerim Rrema,** hartoi raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore që preken nga zbatimi i kësaj lejeje.
Duke filluar nga data 16.09.2026 deri në datën 23.09.2026, grupi i punës mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe realizoi verifikimin në terren e në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore, objekt për heqjen nga fondi pyjor publik të sipërfaqes së kërkuar.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor rezulton se sipërfaqja e kërkuar që hiqet nga fondi pyjor publik është **4.64 ha** dhe shtrihet në pasuritë si mëposhtë:

Nr	Ek Pyjore	Ngastra/pasuria
1	Mali i Kakarriqit	31
2	Mali i Kakarriqit	15e
3	Mali i Kakarriqit	31b 682/2 ZK 1783 pronë private

Sipërfaqet pyjore përveç pasurisë 682/2 janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" si dhe në pronësi private .

Përshkrimi parcelar i sipërfaqeve në objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat që i bashkangjiten këtij raporti teknik. Nga verifikimi në terren rezultojnë të dhënat e pasqyruara në tabelat bashkangjitur raportit teknik.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.** e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesorë të sipërfaqes në pasuritë pyjore si mëposhtë nga të cilat dy janë në pronësi të Bashkisë Lezhë dhe një është në pronësi private.

Nr. Rendor	Nr. Ngastre	Ekonomia Pyjore	Forma e Qeverisjes	Përbërja e grumbullit Pyjor
1	31	Mali I Kakarriqit	Kullotë	Kullotë
2	15e	Mali I Kakarriqit	Kullotë	Kullotë
3	31b 682/2 ZK 1783	Mali I Kakarriqit	Kullotë	Kullotë

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar janë të mbështetura në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e kërkuar, vetëm pas miratimit të heqjes nga fondi pyjor publik dhe pasi ka kryer pagesën e vlerës së materialit drusor prej 2943 lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

a. Vlerën e sipërfaqes së dhënë në përdorim lekë/ha/vit

b. Vlerën e përdorimit të rrugës lekë/km/vit

c. Vlera e Kullotës, (sipas tabelës 4)

1. Bar 49.05kv x 20 lekë = 981 lekë

2. Herba 9.81 kv x 200 lekë = 1962 lekë

Totali (a+b+c) =2943 Lekë

Kompania do të kryejë rehabilitimin mjedisor sipas aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor" të përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Në këtë raport janë bërë vlerësimet e sipërfaqeve pyjore në të cilat do të hiqen nga fondi pyjor publik si rezultat i zhvillimit të aktivitetit të lejes minerare të shfrytëzimit për mineralin gur gëlqeror nga Shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.** Bashkangjitur raportit, hartat, tabelat vlerësuese dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria.

HARTUAN RAPORTIN

Inxh. Ardit Molla **Inxh. Eralba Mirashaj** **Inxh. Blerim Rrema**

KONTROLLUAN RAPORTIN

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

DREJTORI

Paulin Gjergji

Bashkia Lezhe
Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)
(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror) **Tabela 1**

ID. Prones	Ekon.Pyjore	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Te dhena te grumbullit pyjor							Fuqia lendore	
						Mosha	K.D	D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	per ha m3	Total m3
LE26 00 031	Mali I Kakarriqit	31		Prodhues	Kullote									
LE26 00 031b Pasuria 682/2	Mali I Kakarriqit	31b		Prodhues	Kullote									
LE26 00 015e	Mali I Kakarriqit	15e		Prodhues	Kullote									

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren)
(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror)

ID. Prones	Ekon.Pyjore Zona Kadastrale	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Te dhena te grumbullit pyjor							Fuqia lendore	
						Mosha	K.D	D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	per ha m3	Total m3
LE26 00 031	Mali I Kakarriqit	31		Prodhues	Kullote									
LE26 00 031b Pasuria 682/2	Mali I Kakarriqit	31b		Prodhues	Kullote									
LE26 00 015e	Mali I Kakarriqit	15e		Prodhues	Kullote									

PLOTËSOI: **Inxh. Ardit Molla**
Inxh. Blerim Rrema
Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI
Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe
Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELË E PËRSHKRIMIT TË SIPËRFAQES KULLOSORE

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror)

Tabela 2

ID Prones	Ekonomia Kullosore Zona kadastrale	Parcela	Bimesia ne %	Sip.sipas tipit te kullotes ne ha			Ngarkesa ne krere qe kullosin				Vlera e kullotes 000/lek	
							Dhen	Dhi	Te trasha	Total		
			Legum, Gram, te tjera	Dimerore	Verore	Total					Ha	Total
LE26 00 031	Mali I Kakarriqit	31	100								300	3330
LE26 00 031b Pasuria 682/2	Mali I Kakarriqit	31b	100								300	654
LE26 00 015e	Mali I Kakarriqit	15e	100								300	4164

PLOTËSOI: **Inxh. Ardit Molla**
Inxh. Blerim Rrema
Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI
Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe
Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

Investime te kryera ne vite

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror) **Tabela 3**

ID Prones	Perdorimi	Ekon.pyj/ kullos	Parc	Sip total ha	Sip me punime	Viti I kryerjes punimeve	Punimi I kryer ne ha/m3			Vlera investimit 000/leke
							pyllezim	permires	sist.mal	
LE26 00 031	Kullote	Mali I Kakarriqit	31	11.10						
LE26 00 031b Pasuria 682/2	Kullote	Mali I Kakarriqit	31b	2.18						
LE26 00 015e	Kullote	Mali I Kakarriqit	15e	13.88						

Kjo tabele plotesohet nese ka pasur investime te realizuar ne vite

PLOTËSOI: Inxh. Ardit Molla
Inxh. Blerim Rrema
Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI
Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe
Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror) **Tabela 4**

Perdorimi i territorit	Sip.Ha	Asortimenti	Sasia kv	Vlera		Siperfaqja	Vlera e siperfaqes ne perdorim		Gjatesia e	Tarifa dhenie ne perdorim lek/km/vit		TOTALI
	qe hiqet		sipas asortimenteve	lek/kv	Shuma I	ne perdorim ne ha	lek/ha per 2 vjet	Shuma II	perdorimit km rruge	per 2 vjet	Shuma III	I+II+III
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	13
Trungishte pi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Trungishte Pi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Cungishte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Cungishte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kullote	3.27	Bar	49.05	20	981	0	0	0	0	0	0	981
B.pyjore+Djerr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inproduktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bime mjek/med	3.27	Herba	9.81	200	1962	0	0	0	0	0	0	1962
Gjuetia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest realizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	3.27	0	58.86		2943.0	0	0	0	0	0	0	2943

PLOTËSOI: **Inxh. Ardit Molla**
Inxh. Blerim Rrema
Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI
Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe
Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

LISTA E PRONAVE TË FONDIT PYJOR BASHKIAK QE HIQEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR

Tabela 5

(Heqje nga fondi pyjor per shfrytezim te mineralit gur gelqeror)


Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ n/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha	Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor ha	Gjatesia ne perdorim km		
						Rruge	Linje	Tubacion/ kanal
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	LE26 00 031	Mali I Kakarriqit	31	2.92	0	0	0	0
	LE26 00 031b Pasuria 682/2 (prone private)	Mali I Kakarriqit	31b	1.37				
2	LE26 00 015e	Mali I Kakarriqit	15e	0.35	0	0	0	0
				4.64	0	0	0	0

PLOTËSOI: **Inxh. Ardit Molla**
Inxh. Blerim Rrema
Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI
Inxh. Artan Palushi


Shenim:
Ne rastin e Hec-eve,rrugeve apo linjave gjatesore, plotesohet e gjithe tabela.. Kollona 6 llogaritet ne siperfaqe per efekt te llogaritjes se volumeve qe hiqen dhe kollonat 7-9 per tarifen e perdorimit ne km /lek/ vite
Ne rastet e heqjes nga fondi pyjor per ndertime, miniera rruge etj plotesohet tabela deri ne kollonen 5

HARTA E EKONOMISE PYJORE "MALI I KAKARRIQIT"



PLANVENDOSJA MBI HARTEN PYJORE , SH. 1:10000

0 250 500 METER



PLANVENDOSJA MBI HARTEN TOPOGRAFIKE , SH. 1:10000



PLANVENDOSJA MBI ORTOFOTO 2015 , SH. 1:5000

IDENTIFIKIMI I PARCELAVE

ZONA KADASTRALE : 1783
ADRESA: BALLDREN, BASHKIA LEZHË
NGASTRA PYJORE E PREKUR :

- LE 26 00 (031) - Sipërfaqe = 29183 m^2 (2.92 ha)
- LE 26 00 (031b) - Sipërfaqe = 13694 m^2 (1.37 ha)
- LE 26 00 (015e) - Sipërfaqe = 3510 m^2 (0.35 ha)

Siperfaqja totale qe do hiqet nga fondi pyjor : 46387 m^2 (4.6 ha)

LEGJENDA

- KUFIRI I SIPERFAQES QE DO HIQET NGA FONDI PYJOR
- NGASTRAT PYJORE LE 26 00 (031) dhe LE 26 00 (015h)
- SIPERFAQJA E LEJES MINERARE TE SHFRYTEZIMIT
- NGASTRAT PYJORE KUFITARE
- PASURI PRIVATE

SPECIFIKIME TEKNIKE

- SISTEMI KOORDINATIV : KRGJSH
- LARTESIA : ABSOLUTE
- HARTA PYJORE
- HARTE TOPOGRAFIKE (K-34-76-C-b-1)
- ORTOFOTO 2015

Pika	X_KRGJSH	Y_KRGJSH
1	469591.679	4632825.743
2	469774.111	4632593.155
3	469871.325	4632643.064
4	469857.881	4632663.031
5	469923.181	4632688.109
6	469852.52	4632782.736
7	469791.504	4632864.448
8	469738.592	4632811.269
9	469679.155	4632877.529

AUTOR	ING.LUÇIANO KASNECI
POROSITES	"LEZHA KONSTRUKSION" SH.P.K

ELITE SURVEYING
Eng. LUÇIANO KASNECI

VULA

Luciano Kasneci

Digitally signed by Luciano Kasneci
Date: 2026.10.28 20:22:14 +02'00'

BASHKIA LEZHË
Protokolli
Kartelë shoqëruese e praktikës

I.Dërgues Ministria e Mjedisit Tiranë
Nr._____Prot., Datë ____.____.2026

II.Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 17686 Prot., Datë 14.9.2026
Përmbajtja : Miri përgatitjen e raportit teknik

III.Për t/u trajtuar nga : 1. ~~URBANISTIKA~~ Datë ____/____/2026
2. BUXHETI

Shënim i Kryetarit _____

Afati kthimit të përgjigjes: ☐ 7 ditë ☐ 5 ditë ☐ 3 ditë ☐ 2 ditë ☒ **Urgjent (brenda ditës)**
Firmë_____

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse _____, *Datë* ____/____/2026
V.Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës_____, Datë ____/____/2026
Shënim i Drejtorit të Drejtorisë:
Pesonel i autit drejtuar Dr. Buxhetit sepse kërkohet hapja nje fondi pyjor
Firmë_____

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës A. Peleshi, Datë 15/09/2026
VII.Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës A. Malla, B. Rrema, E. Mirashaj Datë ____/____/2026
Shënim i Përgjegjësit të Sektorit:
Të bëhet gjeoreferimi i hartës dhe të hartohet Raporti teknico-ekonomik.
Firmë_____

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës _____, Datë ____/____/2026
Firmë _____

IX. Dorëzim i Eprorit porositës, Datë ____/____/2026
X. Shënim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT
DREJTORIA E BIODIVERSITETIT

Nr._____ prot.

Tiranë, më ___.___.2026

Lënda: Mbi përgatitjen e raportit teknik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të këshillit bashkiak

BASHKISË LEZHË

Për dijeni: **SHOQËRISË "LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.**
Fshati Gocaj, Rruga Balldre-Kakarriq, Zk nr.1873, me pasuri nr.682/2.

Në vijim të kërkesës së shoqërisë "Lezha Konstruksion" sh.p.k. ardhur *on line* datë 28.07.2026, lidhur me procedurën e heqjes nga fondi pyjor publik për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të gëlqerorit, në objektin "Balldre", Bashkia Lezhë, bazuar në Lejen e Shfrytëzimit minerar nr. 647/3, datë 22.04.2024 dhënë për shoqërinë "Alba Kurbin" sh.p.k. dhe transferuar me Aktin e Miratimit nr. 647/4 nga MIE, si dhe Leje Mjedisi të tipit B me nr. identifikimi 5049, datë 4.06.2026, ju informojmë se:

Referuar ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet"; VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kapitulli II, pika 5 dhe 6; VKM-së nr. 684, datë 2.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433, datë 8.06.2016 "Për transferimin sipas listave të inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive, në pronësi të bashkive", të ndryshuar, nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, kërkohet përgatitja e raportit tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore publike dhe private sipas lejes së shfrytëzimit minerar, që hiqet nga fondi pyjor publik sipas dokumentacionit të paraqitur në sistem .

Dërgimi i raportit tekniko-ekonomik duhet të shoqërohet dhe me dakortësinë me vendim të Këshillit të Bashkisë, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli *III*, të V.K.M. nr. 888, datë 27.12.2022, i cili duhet të përmbajë të dhënat kadastrale për sipërfaqen që hiqet.
Një kopje e dokumentacionit të përgatitur dërgohet pranë Ministrisë së Mjedisit nëpërmjet sistemit, për vijimin më tej të procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe pakësimin në volum.

Ledina Beqiraj Agalliu
Digitally signed by Ledina Beqiraj Agalliu
Date: 2026.08.19 09:31:06 +02'00'

Gjithashtu, në sistem, gjeni dokumentacionin ligjor dhe teknik të depozituar nga shoqëria.

Lutemi kryerjen e procedurave të cituara më lart, **brenda afateve ligjore** të përcaktuara në VKM nr.888/2022, kapitulli II, pika 6.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr.4161/8 prot.
LA

Tiranë, më 22.04.2024

Lënda: Akt – Miratimi mbi kërkesën me numër çështje: LC – 4470 – 08 – 2023.

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
Blv: " Zhan D'Ark", Prane Ministrisë së Jashtme,Tiranë.

AGJENCISË KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
"Blloku Vasil Shanto", NR.18, Tiranë.

SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR
Rruga: " Myslym Keta", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR TË SIGURISË DHE EMERGJENCAVE NË MINIERA
Rruga: " Lord Bajron ", Laprakë, Tiranë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Akt – Miratimin Nr.647/3, për shtyrje afati të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.647/2, dt 07/09/2001,*(leje e mëparshme)* për mineralin Gur Gëlqeror të subjektit " **ALBA KURBIN "Sh.p.k.** për kërkesën në QKB me numër çështje **LC – 4470 – 08–2023. dt 17.08.2023,** në objektin " Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Ky Akt - Miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit te AKBN, për lejen minerare Nr.647/2, dt 06.09.2013 për vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, opinionin e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, me Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.102/2023, dt 20.12.2023,"*Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për zgjatje afati të Lejes Minerare te Shfrytëzimit Nr.647/2, datë 07/09/2013, të subjektit " ALBA KURBIN"Sh.p.k. aplikuar në QKB, me kërkesën nr.*LC–4470–08–2023, datë 17.08.2023,të subjektit " ALBA KURBIN "sh.p.k, (Nr.846, prot MIE, dt. 23.01.2024 dhe Nr. 546/1, prot AKBN, datë 23.01.2024)

Faleminderit për bashkëpunimin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI

Belinda Balluku

Me Autorizim
ZËVENDËSMINISTRI

Enkelejda Nuçaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr.614/15 prot. Tiranë, më 22.04.2024

Lënda: Njoftim për Garancitë Financiare.

SHOQËRISË " ALBA KURBIN " SH.P.K

Lezhë, Ballëren Gocaj,Fshati Gocaj, Rruga Ballëre – Kakarriq, ZK Nr.1873, me pasuri nr.6822.

Për dijeni : **QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**
Blv: " Zhan D' Ark", Pranë Ministrisë së Jashtme,Tiranë.

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
" Biloku Vasil Shanto ", Nr.18, Tiranë.

SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR
Rruga: " Mysliym Keta", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR TË SIGURISË DHE EMERGJENCAVE NË MINIERA
Rruga: " Lord Bajron ", Laprakë, Tiranë.

Ju njoftojmë se, në Akt – Miratimin Nr.647/3, shtyrje afati e Lejes Minerare të Shfrytëzimit nr.647/2, datë 07.09.2001, *(leje e mëparëshme.)* për mineralin gur gëlqeror të subjektit "ALBA KURBIN,, Sh.p.k. për kërkesën në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër çështje, I.C – 4470-08-2023 dt 17.08.2023, në objektin " Ballëren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, është përcaktuar se;

"Përfituesi i lejes minerare është i detyruar të respektoje kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineralit për të cilët i është dhënë kjo lejë".

Konkretisht, në Akt – Miratimin Nr.647/3, citohet se;

1. Vlera e garancisë financiare për vitin maksimal për realizimin e planit të investimit, e miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **40 000 lekë.**

2. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për 10 vitet shtesë, në Akt – miratimin nr.647/3, e miratuar me VKT të AKBN (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **0,0 lekë.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

MINISTRI

Nr. 896 Prot. Tiranë, më 23/04/2024

AKT – MIRATIMI NR. 647/3

Për Aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për Leje Minerare Shfrytëzimi, me numër çështje **LC-4470-08-2023, datë 17.08.2023,** dorëzuar nga ana e subjektit **" ALBA KURBIN" Sh.p.k.** për shtyrje afati të Lejes Minerare të Shfrytezimit **nr.647/2, date 07/09/2001,** zotëruar nga ana e subjektit **" ALBA KURBIN"Sh.p.k** (leje e mepareshme) **për mineralin Gur Gëlqeror** , që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin **" Balldren ", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.**

I. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:

a) Emri i subjektit: **" ALBA KURBIN " Sh.p.k.**
(NUIS K 97 81 73 02 P)
b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes: z. **Ilir Nabolli**
c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja: **Gur Gëlqeror.**
ç) Adresa e selisë së subjektit: Lezhë, Balldren Gocaj,Fshati Gocaj, Rruga Balldre – Kakarriq, ZK Nr.1873, me pasuri nr.682/2, .
d) Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: Ilir Nabolli.
Nr.telefonit /faksit: **Cel; 068 20 54 201**
e) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti: **Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.**
ë) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: ing. Ndërtim – shfrytëzim miniere, pajisur me leje profesionale, nr.572, datë 05.10.2016
f) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: **pa afat.**

2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 24, dhe kreun e IV të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dalin në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë lejet e mineralit/mineraleve, të përeaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej 10 vjet.

3.Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineralit:

- **Gur Gëlqeror** ,
  që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.

4.Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë:

KOORDINATAT		
PIKA	X	Y
1	46 33 560	43 86 830
2	46 33 795	43 86 650
3	46 33 887	43 86 810
4	46 33 640	43 86 990

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është 0.054 km² *(një e tetë jo me vogël se një e pesta e përcaktuar e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më e madhe se 5(pesë)km²).*Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që bashkëngjitet këtij akt - miratimi, firmosur nga Ministri ka vulën e MIE dhe është pjesë e tij.

5.Përfituesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për kastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.

6.Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës se mëposhtme:

Periudhat e punes sipas viteve te punes.	Aktivitetet	Shpenzimet per programin e investimit
Viti i parë max	Studime teknike, blerje makineri e pajisje, mirëmbajtje rruge, sheshe, sistemime.	400 000 lekë
Totali	**Studime teknike, blerje makineri e pajisje, mirëmbajtje rruge sheshe.**	**1 000 000 lekë**
Periudha e investimit	**10(dhjetë) vite**	

7. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit gjatë periudhës së shtesës se afatit të lejes në programin e investimit sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të përmbajë këto operacione punë: hapje rruge për niveleri e sipërme të karierës, pajisje e makineri me një vlerë totale prej 1 000 000 lekë.

Veprimtaria minerare e shfrytëzimit do të realizohet për shfrytëzimin e mineralit:

a) Prodhim minerali në total, m³	**500 000 m³,**	me 52.5 %	CaO
b) Prodhim minerali në vit, m³	**50 000 m³,**	me 52.5 %	CaO
c) Rezerva gjeologjike	**6 155 600 m³,**	me 52.5 %	CaO
d) Rezerva te nxjerrshme.	**4 528 000 m³,**	me 52.5 %	CaO

Fuqia punetore për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit gjatë periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare do të **9 (nëntë) punonjës.**

e) **Afati shtesë i lejes minerare të shfrytëzimit është 10 (dhjetë) vjet.**

8. Vlera totale financiare për realizimin e programit të investimit gjatë periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare, e miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **1 400 000 lekë.**

8/1. Vlera vjetore financiare për realizimin e programit të investimit gjatë periudhës së shtyrjes *(për vitin me investime më të larta)* e miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **400 000 lekë.**

8/2. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit gjatë periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare (për vitin me investime më të larta) e miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **40 000 lekë.**

9. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për 10 vitet e tjera për periudhën shtesë të afatit të lejes minerare e miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **1 431 313 lekë.**

10. **Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, gjatë periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare e** miratuar me VKT të AKBN, Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024) është **0 lekë.**

Shënim: Subjekti deri në vitin 2023, ka paguar për garancinë e rehabilitimit mjedisor, vlerën 2 083 220 lekë. Për 10 vitet e shtyrjes së lejes minerare për sipërfaqen 3.69 ha vlerën 2 083 220 lekë. Për 10 vitet e shtyrjes së lejes minerare për sipërfaqen 3.69 ha që do të preket nga shfrytëzimi, vlera vjetore e pagesës së garancisë së Rehabilitimit do të jetë 0.0lekë

11. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kushte specifike:

- **Në pjesën lindore të lejes minerare kalojnë rruga Lezhë – Shkodër dhe Balldren-Gjadër. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar të zhvatohet me rreptësi Rregullorja e Teknikës së sigurimit me Lëndë Plasëse. Të merret në konsideratë rrezja e flakërimit të copave, sipas përcaktimeve të Rregullores së Teknikës së Sigurimit, pasi rruget janë shumë afër me lejen minerare.**

- **Në afërsi të zonës ndodhen objekte banimi si, mobilerë, lokal, varreza. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar të zhvatohet me rreptësi Rregullorja e Teknikës së Sigurimit me Lendë Plasëse, për mosdëmtimin e këtyre objekteve.**

a) Të ndjekë e të zbatojë rregulloren e teknikës së sigurimit për minierat dhe karrierat.

b) Të vlerësojë rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar të mjedisit dhe të mos shkaktojë

dëmtime te tij.

c)Te kontrolloje vazhdimisht dhe te mirembaje ne gjendjen teknike shesheti e sigurise ne shkalle dhe ti kushtohet vemendje rregjjes se kendit te projektuar per pjerresine e shpateve te shkallieve, si dhe rrjedhjen e vazhdueshme ne ndarjen e shkalleve ne nen shkalle per nje efektivitet e kontrolit me te mire te procesit te mbjerrjes.

d)Per kushtet gjeografike specifike ne te cilen ndodhet objekti, subjekti duhet te vleresoje sigurimin e mjeteve mbrojtese individuale per punonjesit, sigurimin e pakoteve mjekesore te domosdoshme per ndihmen e pare ne raste nevoje si dhe gjate gjithe kohes duhet te mbaje ne gadishmeri makine transporti ne gjendje pune.

12.Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

13.Përfituesi i kësaj leje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi për detyrat e lëna nga struktura përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese të përcaktuara sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

14.Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë ligjore nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me fax, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose :

MINISTRIT zonjës
i. me postë: ADRESA Rruga " Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë, Shqipëri
ii. me fax.: Nr.....

ZOTËRUESIT I LEJES SHFRYTËZIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SHFRYTËZIMIT

Shoqërisë: " **ALBA KURBIN** " Sh.p.k ;
me poste : Lezhë, Balldren Gocaj,Fshati Gocaj, Rruga Balldre – Kakarriq, ZK Nr.1873, me pasuri nr.6822/2.

ii. me fax: Cel: 068 20 54 201

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

* Shënim:

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor/aksionar/titular kalimi i të drejtave të lejes minerare të shfrytëzimit tek zotëruesi i ri i bëhet në përputhje me kërkesat e VKM nr.357, datë 26.05.2022 "*Për përcaktimin e kritereve dhe të rregullave të transferimit, të të drejtave minerare nga zotëruesi*".

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, administratorin e shoqërisë, apo drejtuesin teknik, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të specifikojë emrat, adresat dhe interesin përkatës të personit apo entin përgjegjës për drejtimin e operacioneve në zonën e lejuar duke njoftuar 10 (dhjetë) ditë kalendarike më parë me shkrim Ministrin për realizimin e këtij ndryshimi.

Ky ndryshim duhet të dërgohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Ministri sipas ndryshimeve të reflektuara në Ekstraktin e Regjistrit Tregtar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e shfrytëzimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje shfrytëzimi.

Ky Akt-Miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN për shtyrjen e afatit të lejes minerare të shfrytëzimin nr.647/2 datë 07.09.2013,vlerësimin për kushtet e lejimit nga AKBN, opinionin e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN,Nr.102/2023, datë 20.12.2023, me (Nr.846, prot MIE, datë 25/01/2024 dhe nr.546/1, prot AKBN dt 23.01.2024).

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

Belinda Balluku

Me Autorizim

ZËVENDËSMINISTRI

Enkelejda Muçaj

Tiranë me ..../...../2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

LEJE

PN-2624-06-2026

NUIS/NIPT: K48130527H

LEZHA KONSTRUKSION

Adresa: Lezhe LEZHE Zejmen Adresa: Superstrada LE-TR, km 6, Sheshi LEZHA KONSTRUKSION, ZK 3641, numri i pasurise 116/72; 116/73-B1; 116/73-N1;

Kodi: III.1.B

Kodi tjeter:

Data e lëshimit: 05/06/2026

Afati i vlefshmërisë:

Kategoria

Për ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Leje Mjedisi e tipit B

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Leje Mjedisi Tipi B per Instalimi per Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës n minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret

Kufizime specifike

Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Qarku: Lezhe Rrethi: LEZHE B/K: Balldren Q/F: Adresa: Lezhe LEZHE Balldren GOCAJ Lezhe,Balldren,GOCAJ,LEZHE,Vendburimi minerar Balld Gocaj, Lezhe, Zona 424

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLJMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRISË

Nr. 846/4 prot.

Tiranë, më 14.06.2024

AKT – MIRATIMI Nr. 647/4

PËR

TRANSFERIMIN E LEJES MINERARE NR. 647/3, DATË 22.04.2024, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT GUR GËLQEROR, NË OBJEKTIN "BALLDREN", BASHKIA LEZHË, QARKU LEZHË.

Ky Akt-Transferimi për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.647/3, datë 22.04.2024 për shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror, në objektin "Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, bëhet pasi vlerësohen kushtet teknike, profesionale dhe financiare si dhe dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur kërkesës së subjektit "ALBA KURBIN" sh.p.k, paraqitur në QKB me LC-5496-05-2024, datë 21.05.2024.

a) Emri dhe adresa e zotëruesit të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.647/3, datë 22.04.2024 për shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror në objektin "Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Emri i subjektit:	"ALBA KURBIN" SH.P.K
Përfaqësues:	Z. Ilir Nabolli
Adresa: Fshati Gocaj, Lezhë.	Rruga "Balldre-Kakarriq", Zk Nr.1873, me pasuri Nr.682/2,
Lloji i Lejes:	Shfrytëzimi
Lloji i Mineralit:	Gur Gëlqeror
Vendndodhja e objektit:	"Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

b) Emri dhe adresa e subjektit, në të cilën kërkohet të kalojë Leja Minerare e Shfrytëzimit Nr.647/3, datë 22.04.2024, për shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror në objektin "Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Emri Subjektit:	"LEZHA KONSTRUKSION" SH.P.K
Përfaqësues:	Z. Zef Gjetja
Adresa:	Superstrada "Lezhë-Tiranë", km 6, Zejmen, Tresh. Lezhë.
Lloji i Lejes:	Shfrytëzimi
Lloji i Mineralit:	Gur Gëlqeror
Vendndodhja e objektit:	"Balldren", Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Ky transferim bëhet mbi bazën e kërkesës së subjektit "ALBA KURBIN" sh.p.k, në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.10 304, datë 15.07.2010, "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 41, të tij dhe VKM-së Nr.357, datë 26.05.2022, "*Për përcaktimin e kritereve dhe të rregullave të transferimit të të drejtave minerare nga zotëruesi*".

c) Data e transferimit të Lejes Minerare është data e regjistrimit të këtij transferimi në regjistrin e lejeve dhe licencave/Autorizimeve pranë institucionit të QKB-së.

d) Është përgjegjësia e zotëruesit të lejes, subjektit "ALBA KURBIN" sh.p.k dhe kërkuesit të lejes, "LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k, të zbatojnë kërkesat e nenit 42, të Ligjit Nr.10 304, datë 15.07.2010, "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

e) Zotëruesi i lejes gjatë ushtrimit të drejtave që siguron kjo leje, duhet të plotësojë detyrimet e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit, përcaktuar në nenin 36, të Ligjit Nr.10 304, datë 15.07.2010, "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

f) Kërkuesi të njoftohet për miratimin e kërkesës nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

g) Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minierave dhe Industrisë, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), të reflektojnë ndryshimet përkatëse.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENKELEJDA MUÇAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	**Nr. Personal NIPT**	**Pjesa(-/-)**
LEZHA KONSTRUKSION	K48130527H	1/1

Numri i Pasurisë	682/2		
Kodi Unik	1873003191		
Zona Kadastrale	1873		
Lloji i Pasurisë	KULLOTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	**Totali:** 21805	**Truall:** 0	**Ndërtesë:** 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	21805		
Adresa e Pasurisë	LEZHE, LEZHE, Rr.: GOCAJ		

DREJTORI
Gentian Malotaj

Gentian Malotaj
Digitally signed by: Gentian Malotaj
Date: 2022.09.26 03:04:49 +02'00'

Data e lëshimit 22/09/2022

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Lezhë
Date:2022/09/22 12:27:28 +02'00'
K48130527H20220922122727 8L1014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

ASHK
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Miratuar me VKM 782, Datë 07.10.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1873

KODI UNIK: 1873 003 191

NUMRI PASURISË : 682/2

INDEX I HARTËS : K-34-76-(133-A)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:2500

DREJTORI
Gentian Malotaj

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Lezha
Date:2022/09/26 15:06:27 +02'00'
K48130527H20220926150604090l4

Data e leshimit 23/09/22

SHPJEGUES

PARCELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1873003191
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1873 , Lloji i Pasurisë: KULLOTE , Nr. i Pasurisë: 682/2 , Sipërfaqja Totale 21805 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale 133-A , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia LEZHE , Rruga GOCAJ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:
Fillestare 21805 Leke (Akti Nr. 2340/1381 , Dt. 14/06/2022), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: LEZHA KONSTRUKSION , Nr. Identifikimi/NIPT K48130527H , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia LEZHE , Rruga LEZHE , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Kontratë shitje , Nr. 2340/1381 , Datë: 14/06/2022
Regjistruar: Nr. 857 , Datë: 08/09/2022

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____